



REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 dhjetor 2014
Nr. ref.: RK737/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI36/14

Parashtrues

Bojan Đokić, Ljubica Đokić, Zvonko Đokić dhe Đorđe Đokić

**Ankesë për mungesë të hetimeve të një vrasjeje dhe
të kompensimit për shkatërrimin e pronës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bojan Đokić, znj. Ljubica Đokić, z. Zvonko Đokić dhe z. Đorđe Đokić, me vendbanim në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës nuk i referohen qartë ndonjë vendimi të veçantë të një autoriteti publik që duhet të kontestohet.
3. Ata ankohen kryesisht përkitazi me dështimin e autoriteteve “*që të zhvillohen hetimet, për t’i zbardhur të gjitha rrethanat e vrasjes*” së një personi të afërm.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit në mungesë të hetimit penal për vrasjen e të afërmit të tyre dhe mungesës së kompensimit për shkatërrimin e pronës. Parashtruesit konsiderojnë se të drejtat e tyre ishin shkelur, përkatësisht siç garantohen me nenin 2.6 dhe 13 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 46 të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa me sa duket bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 shkurt 2014, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 6 mars 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 15 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kallëzimit penal dhe kërkoi dokumentacion shtesë lidhur me ankesën që ata kishin paraqitur më 8 tetor 2004 te Prokurori Publik në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
9. Më 12 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues vendosi njëzëri që ta shtyjë shqyrtimin e kërkesës për seancën e radhës. Kolegji shqyrtues në veçanti i rekomandoi gjyqtarit raportues që të komunikojë me parashtruesit e kërkesës dhe palët përgjegjëse me qëllim të plotësimit dhe qartësimit të fakteve të kërkesës.
10. Kështu, më 15 maj 2014, nga parashtruesit e kërkesës ishte kërkuar që ta informojnë Gjykatën për numrin e regjistrimit të kallëzimit penal dhe të bashkëngjisin ndonjë përgjigje nga gjykatat që ata mund t’i kenë.
11. Më 15 maj 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke u kërkuar që ta

informojnë “nëse ka ndonjë procedurë në zhvillim e sipër” lidhur me kallëzimin penal, dhe nëse ka, në çfarë faze është ajo procedurë.

12. Për më tepër, më 15 maj 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Ferizaj, duke kërkuar nga ajo që ta informojë “nëse ka ndonjë procedurë në zhvillim e sipër” lidhur me padinë civile të parashtruesve të kërkesës të 17 shtatorit 2004 dhe, nëse po, në çfarë faze është një procedurë e tillë.
13. Më 24 qershor 2014, Gjykata e përsëriti kërkesën e saj për informata shtesë në Zyrën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën Themelore në Ferizaj.
14. Më 25 qershor 2014, Gjykata këmbënguli me kërkesën ndaj Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Zyrës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë për informatat shtesë.
15. Gjithashtu, më 25 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Zyrës së Prokurorisë Speciale në Prishtinë dhe kërkoi informata lidhur me procedurën, nëse ka, përkitazi me kallëzimin penal.
16. Më 30 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës Bojan Đokić plotësoi kërkesën në emër të të gjithë parashtruesve të tjerë.
17. Më 10 korrik 2014, Zyra e Prokurorisë Speciale njoftoi Gjykatën “që Zyra e Regjistrimit në PSRK deri tani nuk ka pranuar asnjë kërkesë lidhur me rastin e sipërpërmendur”.
18. Më 14 korrik 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Prokurorit të Shtetit dhe kërkoi të gjitha informatat në dispozicion lidhur me veprimet eventuale të ndërmarra në lidhje me kallëzimin penal.
19. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Robert Carolan.
20. Më 5 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

21. Më 24 qershor 1999, një i afërm i parashtruesve ishte vrarë në Ferizaj, nga një person ose disa persona të paidentifikuar dhe prona e tij ishte plaçkitur, ndërsa dy shtëpitë dhe objektet ndihmëse ishin djegur.
22. Më 25 korrik 1999, neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1 për autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë përcaktoi se “1. Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”.
23. Në vitin 2002, kufoma e të ndjerit ishte identifikuar dhe mbetjet e tij mortore ishin marrë nga të afërmit, parashtruesit e tanishëm të kërkesës.

24. Më 17 shtator 2004, parashtruesit parashtruan padi civile kundër Qeverisë së Kosovës, Komunës së Ferizajt, UNMIK-ut dhe KFOR-it, në Gjykatën e atëhershme Komunale në Ferizaj për kompensim të shkatërrimit dhe dëmtimit të pronës së tyre (në tekstin e mëtejme: *padia civile*).
25. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë se *“Për të gjitha këto detaje është njoftuar Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë, më 8. 10. 2004”*.
26. Më 15 qershor 2008, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi.
27. Si rezultat i kërkesës për informata nga Gjykata, është gjetur se më 19 dhjetor 2011, Gjykata në Ferizaj (Aktgjykimi P. nr. 1403/04) vendosi që të *“hudhet si e pa lejuar padia e palës paditëse për shpërblimin e dëmit (...)”*.
28. Gjykata gjithashtu konstatoi se në lidhje me vrasjen e lartpërmendur nuk ishte filluar asnjë procedurë penale e as nuk ishin në procedurë e sipër në instancat e ndryshme prokuroriale apo gjyqësore.
29. Për më tepër, Gjykata Themelore në Ferizaj informoi se vendimi i Gjykatës në Ferizaj, i 19 dhjetorit 2011 asnjëherë nuk i është komunikuar parashtruesve as nuk ishte publikuar në ndonjë gazetë zyrtare.

Ankesat e parashtruesve

30. Parashtruesit e kërkesës ankohen për dështimin e autoriteteve publike të Kosovës *“të veprojnë sipas kërkesave të shtruara në fletëdenoncimin penal dhe me qëllim që të zhvillohen hetimet, për t'i zbardhur të gjitha rrethanat e vrasjes së të ndjerit (...), sidomos për shkak se nuk janë zbuluar dhe proceduar kryerësit e vrasjes. Ankesa, po ashtu, paraqitet edhe për shkak të shkatërrimit të pasurisë dhe për mosveprim sipas padisë për kompensimin e dëmit”*.
31. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *“... me vrasjen e të ndjerit (...) dhe plaçkitjen e shkatërrimin e pasurisë së tij, janë shkelur: e drejta për jetën – neni 2 i Konventës në tërësi, neni 6. par. 1 i Konventës; – e drejta për gjykim të drejtë dhe gjykim brenda një afati të arsyeshëm, neni 13 i Konventës – e drejta për një mjet efektiv juridik dhe Protokollin I – mbrojtja e pronës. Kushtetuta e Kosovës: nenet 3 dhe 24 – barazia para ligjit, neni 25 – e drejta për jetën, neni 31 – gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, neni 32 – e drejta për mjet juridik, neni 46 – mbrojtja e pronës, neni 54 – e drejta për mbrojtje gjyqësore”*.
32. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata:

“të gjenden dhe të procedohen vrasësit e të ndjerit (...); që të zbulohet se kush ua ka plaçkitur pronën dhe në fund e ka djegur atë; që t'u paguhet dëmi material dhe ai jomaterial, shkaktuar me vrasjen e të ndjerit (...) dhe me shkatërrimin e pronës”.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në

Rregullore të punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

34. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës i përqendrojnë ankesat e tyre kryesisht në dy çështje: veprimet dhe mosveprimet në hetimin e vrasjes së të afërmit të ndjerë (...) dhe kompensimin e dëmeve për plaçkitjen dhe shkatërrimin e pronës.
35. Për më tepër, Gjykata paraprakisht vëren se fakti kryesor i vrasjes ndodhi më 24 qershor 1999, që do të thotë para se UNMIK-u të kishte marrë përsipër “*administrimin e gjyqësorit*” dhe padia civile ishte parashtruar në Gjykatën e Ferizajt më 17 shtator 2004, do të thotë shumë kohë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008.
36. Gjykata konsideron se çështja e parë dhe kryesore që duhet të analizohet është nëse ngjarjet të cilat kanë ndodhur në vitin 1999 bien nën juridiksionin e saj kohor. Ky konsiderim paraprak është relevant me analizimin e ankesave të parashtruesve.
37. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kryesisht pohojnë: (i) shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, (ii) shkelje të nenit 6. 1 dhe 13 të KEDNJ-së dhe (iii) shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me Protokollin I të KEDNJ-së. Shkelja e dytë e pretenduar dhe shkelja e tretë e pretenduar janë logjikisht të ndërvarura. Prandaj, Gjykata do të analizojë pretendimin e parë.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h) të Rregullores, i cili parasheh:

“Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese: ... kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.
39. Gjykata, duke identifikuar çështjen kryesore në analizë, gjithashtu rikujton se është e obliguar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut.
40. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) në rastin *Mladenović kundër Serbisë*, Kërkesa nr. 1099/08, Aktgjykimi i 22 majit 2012, në paragrafin 38, thotë si më poshtë:

*“Në pajtim me rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (veçanërisht, neni 28 i Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve), Konventa nuk e detyron një palë ndaj ndonjë akti apo fakti që ka ndodhur ose ndonjë situatë cila ka pushuar së ekzistuari para datës së hyrjes në fuqi të traktatit dhe që ka lidhje me atë palë. (shih *Blečić kundër Kroacisë* [DHM], nr. 59532/00, § 70, GJEDNJ 2006-III). Megjithatë, është e qartë nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me nenin 2 se obligimi procedural për të hetuar ka evoluar në një detyrë të veçantë dhe autonome, në gjendje që të obligojë shtetin edhe kur vdekja ka ndodhur para ratifikimit (shih *Šilih kundër Sllovenisë* [DHM], nr. 71463/01, § 159, 9 prill 2009). Duke pasur parasysh parimin e sigurisë juridike, juridiksioni kohor i Gjykatës në këtë drejtim megjithatë nuk është i pakufishëm (ibid, § 161). Kur vdekja ka*

ndodhur para ratifikimit, vetëm aktet procedurale ose mosveprimet e kryera pas kësaj date mund të bien brenda juridiksionit kohor të Gjykatës (ibid, § 162). Për më tepër, duhet të ketë një lidhje të vërtetë në mes të vdekjes dhe hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me atë shtet në mënyrë që detyrimi procedural të hyjë në fuqi. Në praktikë, kjo do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e hapave proceduralë të kërkuar nga kjo dispozitë ka qenë, ose duhet të jetë kryer pas ratifikimit. (Shih Hackett kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 34698/04, 10 maj 2005)”.

41. GJEDNJ gjithashtu konsideronte se “në rastet që kanë të bëjnë me obligimin për hetim sipas nenit 2 të KEDNJ, në rast se është shkaktuar një vdekje, pritet që të afërmit e ankuesit të ndërmarrin hapa për të ndjekur procesin e hetimeve dhe të dorëzojnë ankesat e tyre në mënyrën e duhur, sapo ata të jenë ndërgjegjësuar apo të duhet të ndërgjegjësohen për mungesën e një hetimi penal efektiv (Shih, *Bulut dhe Yavuz kundër Turqisë* (vend.), nr. 73065/01, 28 maj 2002; gjithashtu, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë* (vend.), nr. 38587/97, GJEDNJ 2002 III) dhe *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [DHM], nr. 16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90, § 158, 18 shtator 2009). (Shih *Rasti Mladenović kundër Serbisë*, Kërkesa nr. 1099/08, Aktgjykim, 22 maj 2012, para. 45)”.
42. Gjykata thekson se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së kur vendos se ngjarjet që kanë ndodhur para se të hynte në fuqi Kushtetuta më 15 qershor 2008 nuk janë në përputhje *ratione temporis* me Kushtetutën dhe kështu nuk bien nën juridiksionin e saj kohor. (Shih, ndër të tjera, aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI152/11, parashtrues *Bekim Murati*; në rastin nr. KI07/11, parashtrues *Vehbi Klaiqi*; në rastin KI128/11, parashtrues *Ismet Boshnjaku*).
43. Gjykata rikujton se vrasja kishte ndodhur në vitin 1999, parashtruesit e kërkesës kishin marrë mbetjet mortore në vitin 2002 [3 (tri) vjet më vonë], ata pretendojnë se kishin parashtruar një kallëzim penal më 8 tetor 2004 [5 (pesë) vjet më vonë], dhe ata nuk kanë përcjellë zhvillimin proceduralë deri në parashtrimin e kërkesës në Gjykatë më 27 shkurt 2014 [10 (dhjetë) vjet më vonë].
44. Për më tepër, Gjykata përsërit se vrasja kishte ndodhur më 24 qershor 1999, dhe padia civile ishte parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj më 17 shtator 2004.
45. Prandaj, Gjykata konsideron se faktet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës nuk bien brenda juridiksionit kohor të Gjykatës.
46. Si përmbledhje kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës.
47. Gjykata, duke konstatuar se ankesat e parashtruesve janë të papranueshme, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohet veçmas pranueshmëria e ankesave të parashtruesve të kërkesës, të bëra në bazë të neneve 6. 1 dhe 13 të KEDNJ-së, dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

48. Për më tepër, Gjykata konsideron se, duke marr parasysh arsyetimin e konkludimit më lart, dispozitat kushtetuese të referuara nga parashtruesi nuk janë të zbatueshme fare për rastin.
49. Nga sa u tha më lart, Gjykata përfundimisht konkludon se ankesat për shkeljen e pretenduar të nenit 2 të KEDNJ-së nga ana e autoriteteve publike në Kosovë, për shkak të mungesës së hetimeve të një vrasjeje dhe të mungesës së kompensimit për shkatërrimin e pronës, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së Punës, nuk janë *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën dhe në këtë mënyrë janë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani